



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:907406

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05433701

CA.nr.1202/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Faton Ademi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q.O nga Gj..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shabi Isufi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës S.A, I.N, që të dy nga Gj..., të cilët i përfaqëson Sherif Sherifi, avokat nga Gjilani, Lirije Hyseni dhe të paditurës – kundërshtares së sigurimit D.P nga Gj...të cilën e përfaqëson Sherif Sherifi, avokat nga Gjilani, dhe ndërhyrësve kryesor – propozuesve të sigurimit Aulona Kryeziu, e lindur Sh,R, T dhe Y.Sh që të gjithë nga Gj..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Burim Islami, avokat nga Gjilani, duke vendosur sipas ankesës së kundërshtares së sigurimit, e paraqitur kundër aktvendimit C.nr. 1231/2023 i datës 27.11.2023, të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, në seancën jo publike të kolegjit e mbajtur, me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e përfaqësuesit të kundërshtares së sigurimit D.P. nga Gjilani, PRISHET aktvendimi C.nr. 1231/2023 i datës 27.11.2023, i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, dhe lënda i kthehet në, për procedim të serishëm në njëjtën gjykatë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr. 1231/2023 i datës 27.11.2023, ka vendosur si në vijim: *“KONSIDEROHET i tërhequr kundërshtimi i kundërshtares të masës së sigurisë i datës 06.11.2023, i paraqitur ndaj aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, i datës 24.10.2023”*.

Kundër këtij aktvendimi, përmes përfaqësuesit të saj kundërshtarja e sigurimit D.P., në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të prishet, dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e kundërshtares së sigurimit është e themeltë:

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 28.10.2010, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurve, me objekt kontesti anulim kontrate. E paditura – kundërpropozuesja përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, më datë 02.11.2021, ka paraqitur kundërshtim, ndaj Aktvendimin C.nr.1231/2023, të datës 24.10.2023, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Gjykata e Shkallës së parë, e ka caktuar seancën dëgjimore më datën 23.11.2023 në ora 14:30, për të cilën seancë i ka ftuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë vlerëson se në seancën dëgjimore se autorizuari i kundërshtares së masës së sigurisë nuk ka prezantuar në këtë seancë edhe pse i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë, krejt kjo bazuar nga fletë dorëzimit personal që i është kthyer gjykatës nga ana e dorëzuesve nga i cili është konstatuar se i njëjti ftesën për seancë gjyqësore e ka pranuar më datën 21.11.2023, por se mungesën e tij në seancë nuk e ka arsyetuar. Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitën e nenit 409 paragrafi 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, gjykata e konsideroj të tërhequr padinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 pika 2, lidhur me nenin 409 paragrafi 2 të LPK-së.

Deri tek shkelja e dispozitave të sipërcituara ka ardhur për arsye se gjykata e shkallës së parë në këtë rast nuk ka mundur t’ a konsiderojë si të tërhequr kundërshtimin e kundërshtares së sigurimit në këtë rast, duke u bazuar në nenin 409 paragrafi 1 të LPK-së, ngase pasojat nga dispozita ligjore e lartcekur për mos prezantim në seancë, janë vetëm në raport me paditësin në këtë rast, por jo edhe në raport me kundërshtarin e sigurimit, siç ka vendosur Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, për më tepër kjo gjykatë vlerëson se nuk ka qenë asnjë pengesë ligjore

që seanca të mbahet edhe pa prezencën e të paditurit/kundërshtarit të sigurimit, kur plotësohen kushtet tjera procedurale, në kuptim të nenit 409 paragrafi 2 dhe neni 423 paragrafi 3 i LPK-së.

Në rastin konkret aktvendimi ka të meta për shkak të te cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos dispozitivi i aktvendimit pasi që i njëjti është kontradiktor me arsyet e dhëna në aktvendim sepse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar është vendosur që kundërshtarit të sigurimit ti konsiderohet i tërhequr kundërshtimi, ndërsa në arsyet e vendimit të ankimuar është arsyetuar për mos prezencën e paditësit në seancë, andaj këto arsye janë të paqarta, ose kontradiktore dhe siç shihet edhe janë kundërthënëse midis asaj që është vendosur me aktvendimin e ankimuar dhe asaj që është arsyetuar. Andaj nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipërcituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që gjykata të veprojë sipas vërejtjeve të paraqitura më lartë dhe varësisht nga situata procedurale të ndërmerre veprime tjera për përgatitjen e gjykimit dhe vendosjen e çështjes në mënyrën meritore.

Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.1202/2024 me datë 11.03.2024

Kryetar i kolegjit
Adnan Konushevci d.v